

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**HOXHAJ & PARTNERS LAW FIRM Sh.p.k.**

**I. EMERTIMI, ORTAKET, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA**

Neni 1

Emertimi i shoqerise eshte Hoxhaj & Partners Law Firm Shpk., me poshte e quajtur "Shoqeria".

Neni 2

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

Neni 3

Shoqeria e ka seline e saj ne adresen Rr. Komuna e Parisit, Kompleksi Le Serre, Shkalla 6, Ap. 3, Tirane, Shqiperi.

Neni 4

Shoqeria ka per objekt ofrimin e sherbimeve ligjore me dhenien e konsulencave juridike dhe perfaqesim gjyqesore per individ, persona fizik dhe juridike shqiptare dhe te huaj.

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar deri ne momentin kur ortaket do te vendosin per mbylljen e shoqerise.

Neni 6

Ortaku i Vetem i Shoqerise eshte **Elona Hoxhaj**

**II. KAPITALI FILLESTAR I SHOQERISE**

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 Leke (njqind), i ndare ne 1 kuote, secila me vlere 100 Leke, krejtesisht te nenshkruara dhe derdhura ne para nga Ortaku i Vetem si vijon:

Elona Hoxhaj 1 kuote

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne perputhje me ligjin shqiptar ne fuqi.



### III. ORGANET E SHOQERISE

#### Neni 8

Ortaku i Vetem i shoqerise sipas legjislacionit shqiptar mund te marre çdo lloj vendimi e pa asnje kufizim, me perjashtim te atyre vendimeve qe jane kompetence e administratorit.

Ortaku i vetem merr vendime per ndryshimin e statutit te shoqerise, shperndarjen e shoqerise, bashkimin ose bashkepunimin ne çfaredo lloj forme me shoqeri te tjera, shtimin ose pakesimin e kapitalit te shoqerise dhe/ose te kuotave te tij, transferimin e nje pjese apo te gjithë kuotave te kapitalit te shoqerise, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, aprovimin e raporteve financiare dhe bilancit brenda gjashte muajve nga perfundimi i vitit financiar te shoqerise, blerjen dhe shitjen e pasurive te paluajtshme.

#### Neni 9

Shoqeria do te administrohet nga Administratori i Vetem i emeruar, per nje afat prej jo me shume se 5 vjet, me te drejte riperteritje, i cili ka te drejte t'u delegoje me prokure personave te trete te zgjedhur prej tij, nje pjese apo te gjitha kompetencat qe i jane caktuar atij sipas ketij statuti dhe qe i njihen nga legjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare. Administratori do te pergjigjet per administrimin e zakonshem te shoqerise, dhe do t'a realizoje ate duke kryer te gjitha veprimet qe ai i konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te shoqerise me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakut te vetem .

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Personi i meposhtem caktohet si Administratore e pare te shoqerise deri ne emerimin e saj nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme:

- 1) **Entela Shpetim Hoxhaj**, lindur me 13.08.1989, ne Fier, Shqiperi me ID I95813081T.

### IV. VITI FINANCIAR

#### Neni 10

Viti fiananciar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti, me perjashtim te vitit te pare financiar, i cili fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2018.

#### Neni 11

Ortaku i Vetem emerone nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre behet i nevojshem ne baze te ligjit shqiptar.



Neni 12

Çdo konflikt qe mund te lindre ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij akti, si dhe çdo konflikt qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve do te jete objekt i zgjidhjes nepermjet vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.


Neni 13

Ky akt mund te ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet pjesisht ose teresisht me vendim te Ortakut te Vetem.

Tirane, me date 20. 2 2018

**ORTAKU I VETEM**

Elona Hoxhaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Elona Hoxhaj', is written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.